



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 13 . 1. 2026

NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR POZICIONIN
E SHPALLUR NGA AZHBR

Bazuar në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, në Urdhrin e Kryeministrit nr. 93, datë 12.6.2024, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, në Urdhrin nr. 20, datë 19.01.2018, “Për krijimin e sporteve unike të shërbimeve për fermerët-Agropika”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 10.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e brendshëm të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin mbi rezultatet e verifikimit për pozicionin e shpallur, si më poshtë vijon:

I. DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE
SPECIALIST INFO-APLIKIMI NË AGROPIKËN PUKË (me kontratë pune 8h/ditë)

• **Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit janë:**

1. Gzim Zmakaj;
2. Xheni Bardeli.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Ligjin nr. 37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”.
- Ligjin nr. 30/2016 datë 17.3.2016, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën “Bujqësia dhe zhvillimi rural” (IPARD).

- Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

- A.** Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **16.1.2026, ora 11:00**, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë.
- B.** Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë **16.1.2026, ora 12:00** dhe në vazhdim, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë. Kandidatët do të paraqiten në intervistë sipas rendit alfabetik.

TË GJITHË KANDIDATËT PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT.

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL